

VENDIM
Nr. 32/2015

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR ZBATIMIN E
PROBLEMATIKËS NË REZOLUTËN PËR MARRËVESHJEN MIDIS
MAZHORANCËS QEVERISËSE DHE OPOZITËS NË KUVENDIN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh dhe Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për zbatimin e problematikës në rezolutën për marrëveshjen midis mazhorancës qeverisëse dhe opozitës në Kuvendin e Shqipërisë.

II. Komisioni i Posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij zbatimin e çështjeve të trajtuara në rezolutën e miratuar nga Kuvendi në datën 24.12.2014.

III. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 4 janë përfaqësues të shumicës parlamentare dhe 3 përfaqësues të pakicës parlamentare. Komisioni i Posaçëm kryesohet nga një përfaqësues i pakicës parlamentare. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

1. Oerd Bylykbashi	Kryetar	PD	
2. Taulant Balla	Zëvendëskryetar	PS	
3. Armando Subashi	Anëtar	PS	
4. Ulsi Manja	Anëtar		PS
5. Spartak Braho	Anëtar	LSI	
6. Eduart Halimi	Anëtar		PD
7. Gent Strazimiri	Anëtar	PD.	

IV. Komisioni i Posaçëm kërkon asistencë nga Bashkimi Europian dhe Komisioni Demokraci Përmes Ligjit pranë Këshillit të Europës (Komisioni i Venecias).

V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij deri në datën 31 maj 2015. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të komisionit, Kuvendi mund të vendosë zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit. Në këtë rast, duhet të mbahet në konsideratë që projektligjet e hartuara nga Komisioni i Posaçëm t'i nënshtrohen votimit në seancë plenare jo më vonë se data 30 qershor 2015, sikundër është rënë dakord në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, të datës 24.12.2014, "Për marrëveshjen politike mes mazhorancës qeverisëse dhe opozitës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë".

VI. Për çështje të patrajtuara në këtë vendim, Komisioni i Posaçëm organizon dhe zhvillon veprimtarinë e tij, mbështetur në dispozitat e Rregullores së Kuvendit për funksionimin e komisioneve parlamentare.

VII. Çdo parti tjetër joparlamentare, që nuk është e përfshirë në këtë komision, ka të drejtë të bëjë propozime pranë komisionit.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për krijimin e kushteve të punës, mbështetjen financiare e logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm, grupit të ekspertëve dhe sekretarisë teknike.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratar në datën 19.2.2015